



DEKLARATË KONFIDENCIALITETI

Objekti

Kjo deklaratë i drejtohet të gjithë stafit të **Komunës së Klinës**, si dhe punonjësve të përkohshëm, vullnetarëve dhe palëve të tjera të cilët kanë qasje në informacionin e mbajtur nga Komuna e Klinës.

Qëllimi

Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga të gjithë ata punonjës të cilët kanë qasje në të dhënat personale të Komunës së Klinës. Ajo përcakton kërkesat dhe përgjegjësitë e atyre që kanë qasje në informacione të tilla dhe siguron që të gjitha palët e interesuara të kuptojnë detyrimet e tyre të konfidencialitetit.

Fusha e veprimit

Fushë veprimi i kësaj deklarate shtrihet për të gjitha të dhënat personale dhe informacione konfidenciale që njihen gjatë punës në Komunën e Klinës. Dispozitat përkatëse zbatohen edhe pasi marrëdhënia e punës me Institucionin ka përfunduar.

Deklarata e konfidencialitetit

Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdor dhe të mos i transmetoj personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga Komuna e Klinës, përveç nëse autorizohem shprehimisht nga Komuna ose kërkohet me ligj.

Unë e kuptoj se ky detyrim vlen gjatë afatit të punësimit si dhe pas përfundimit të tij.

Unë e kuptoj se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, trajtohet nga Ligji nr.06/L-82, për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Unë nuk do të përdorë ose përhap asnjë të dhënë personale që marr dijeni gjatë punës time për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.

Unë e kuptoj se jam i detyruar të ruajë konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t'i mbajë ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.

Marr përgjegjësinë e plotë që në qoftë se konstatohet që kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave personale apo në rast të mos ruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme.

Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të mbajtur standarde të larta profesionale në Komunën e Klinës.

Nënshkrimi i zyrtarit,

Datë: